



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA	
QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA	
MINISTRIA E SHËNDETËSISË-MINISTARSTVO ZDRAVLJA-MINISTRY OF HEALTH	
Njësia Org: Org-Jedinita Org Unit	Nr.Prot: Proj Prot: Prot.No: 05-1341
Nr.i faqeve Br.stranica No. pages	Data: Datum: 21/03/2022
Prishtinë / a	

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Shëndetësisë-Ministarstvo Zdravstva-Ministry of Health
Zyra e Ministrit/Ured Ministra/Office of the Minister

Nr. 48/III/2022
Datë: 21.03.2022

Ministri i Ministrisë së Shëndetësisë, në mbështetje të Nenit 145 (pika 2) e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh nenet 10 dhe 11 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare Nr. 7, 01 Mars 2019), bazuar në Nenin 8 të Rregullores Nr. 02/2021 për fushat e përgjegjësisë administrative të zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, bazuar në Nenin 9 paragrafi 1.13 dhe nenin 89 të Ligjit nr.04/L-125 për shëndetësi, në zbatim të Ligjit nr. 07/L-006 për parandalimin dhe luftimin e pandemisë Covid-19 në territorin e Republikës së Kosovës, në zbatim të Vendimit Nr. 01/11 të datës 15.03.2020 për shpalljen e emergjencës së shëndetit publik, në zbatim të pikës 59 të Vendimit Nr. 01/66 datë: 01.03.2022, nxjerrë:

V E N D I M

1. Aprovohen Udhëzuesit e përkohshëm dhe të veçantë për parandalimin dhe luftimin e COVID-19, me titujt si në vijim:
 - 1.1. Udhëzues i Përkohshëm për aplikimin e masave të përgjithshme për parandalimin dhe luftimin e COVID-19;
 - 1.2. Udhëzues i Përkohshëm për sektorin e shërbimeve personale dhe bizneseve, industrisë, administratës publike dhe OJQ-ve;
 - 1.3. Udhëzues i Përkohshëm për institucionet arsimore të gjitha niveleve;
 - 1.4. Udhëzues i Përkohshëm për gastronomi, hoteleri, sektorin e shitjes dhe qendra tregtare;
 - 1.5. Udhëzues i Përkohshëm për tubimet fetare, varrime, punëtori dhe aktivitete kulturore,
 - 1.6. Udhëzues i Përkohshëm për fitnese, palestra dhe aktivitete tjera rekreative dhe sportive;
 - 1.7. Udhëzues i Përkohshëm për transportin publik;
 - 1.8. Udhëzues i Përkohshëm për institucionet e kujdesit shëndetësor;
 - 1.9. Udhëzues i Përkohshëm për aviacionin civil;
 - 1.10. Udhëzues i Përkohshëm për institucionet korrektuese, qendra të azilit dhe të mbajtjes për të huaj;
1. Obligohen të gjitha institucionet relevante të zbatojnë në përpikmëri këta Udhëzues;

2. Në Shtojcën 1 të këtij Vendimi janë Udhëzuesit relevant të cilët janë pjesë e këtij Vendimi;
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Ministri i Shëndetësisë.

Dr. Rifat Latifi
Minister i Shëndetësisë



Vendim i dërgohet:

- Zëvendësministrave;
- IKSHPK;
- Anëtarëve;
- Sekretarit të Përgjithshëm;
- Departamenti ligjor;
- Arkivit të MSh.

SHTOJCA 1. Udhëzuesit e përkohshëm dhe të veçantë për parandalimin dhe luftimin e COVID-19